



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore

Mbledhja e datës 4 dhjetor 2023

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	2
1.Projektligji “Për buxhetin e vitit 2024”	4
2.Projektvendimi “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit”	5
3.Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004” Për sistemin e adresave” të ndryshuar.....	5
4.Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”	6
5.Projektvendimi “Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale”	7
6.Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin” të ndryshuar.....	8
7.Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimit dhe pagesat”	9
8.Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për projektet që duhen t’i nënshtrohen oponencës teknike dhe procedurat që ndiqen”	9
9.Projektudhëzimi “Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”	10
10.Projektudhëzimi “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumentave që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”	10
Mbyllja e mbledhjes.....	11
Shtojcë: Të pranishëm në mbledhje	

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 910, datë 21.11.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore”, u mbajt mbledhja e gjashtë për vitin 2023 në sallën Balsha, Tirana Hotel International, e Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore, e hënë, datë 4 dhjetor 2023. Në mbledhje merrnin pjesë anëtarët e këshillit konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe donatorë të huaj. Mbledhja u kryesua nga bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ Z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Z. Aldrin Dalipi i cili në fjalën e tij përshëndetëse falenderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e NJVV-ve. Dokumenti kryesor është buxheti vendor për vitin 2024. Z. Mazniku ka kryer vizita në gjitha bashkitë e vendit dhe ka dëgjuar nevojat e bashkive për buxhetet përkatëse. Në fjalën e tij Z. Mazniku falenderoi njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe qeverisjen qendrore si dhe theksoi rëndësinë e diskutimit të buxhetit duke vlerësuar opinionin e bashkive. Nevoja financiare e bashkive është në rritje me kërkesat e tyre, buxheti është rritur me 4%, transfertat është rritur me 10.4%, mbështetja për bashkitë nga qeveria është prioritare, grantet nga bashkia në bashki janë rritur nga 12-17 %. Gjatë vitit të ardhshëm duhet të rishikojmë skemën e financimit të bashkive, formulën e transfertës, taksat e ndara dhe transfertat sektoriale, sasinë dhe tipologjinë e bashkive për të mbledhur të ardhurat e veta. VKM nr.910/2016 për funksionim e Këshillit Konsultativ do ketë ndryshime, ku do bëhet e mundur diskutimi i projektakteve në tryeza teknike, konsultimi në rang bashkish me qeverinë, me praninë e juristëve apo punonjësve sipas fushave para diskutimit politik. Këshilli Konsultativ të jetë më proaktiv duke sjellë propozime dhe nga krahu i bashkive. Për zonat e mbrojtura kemi një iniciative nga bashkitë për përmirësimin e legjislacionit.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektligji “Për buxhetin e vitit 2024”

Z. Fran Brahim, Drejtor për Financat Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, prezantoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Mbështetja për buxhetin vendor ka qënë e konsiderueshme për vitin 2024 me 2.5 miliard lekë më shumë se në vitin 2023, ndërsa për vitin 2023 ka qënë 5.2 miliard lekë më shumë krahasuar me vitin 2022. Buxheti lidhet me produktin e brendshëm bruto (PBB), një tregues makroekonomik. Rregulli i ligjit për financat vendore, si dhe rregulli mbi transfertat e pakushtëzuara nuk duhet të jetë më e vogël se transfertat vitit të mëparshëm. Ndryshmi i popullsisë në census bën që të rishikohet skema e financimit. Transfertat e pakushtëzuara është jo me pak se 1% e PBB dhe transfertat sektoriale, që të dyja bashkë e kalojnë 1% të PBB. Burim tjetër janë taksat e ndara të cilat janë shtesë në buxhetin e tyre. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me ministrinë e tjera ka filluar vlerësimin mbi taksën e pronës ku ndryshohet metoda e taksimit mbi

pasurinë, ku bazë e taksës do jete vlera e pronës, që përbën buxhetin për bashkitë. Me disa bashki po punohet për konsolidimin e buxhetit dhe menaxhimin e tij. Prodhimi i raporteve financiare rrit transparencën dhe korrigjon punën e viteve parardhëse. Buxheti vendor total është 81.1 miliard lekë ose 10.4% më i madh se një vit më parë, ndërsa transfertat janë rritur me 13.4% në krahasim me vitin 2023, ku rezulton se ritmi i tyre është më i madh se ai i rritjes së të ardhurave vendore. Në transfertën sektoriale kemi dhe 600 milion lekë për rritjen e pagave nga vendimi i qeverisë për pagat në administratën publike vendore si dhe 1.5 miliard lekë për administratën e bashkive. Gjithashtu, taksë e pasurisë me digjitalizimin e saj do sjellë një shumë të konsiderueshme në terma afatmesëm dhe afatgjatë. Transferta e kushtëzuar vitin e kaluar ka qënë 21.1 miliard lekë, ndërsa për këtë vit është 2.6 miliard lekë më shumë se në vitin 2023. Transferta sektoriale nga 9.8 miliard lekë është rritur në 10.7 miliard lekë. Për emergjencat civile janë 2.5 miliard lekë ose 600 milion lekë më shumë se vitin e kaluar. Nga ministrinë e linjës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit janë destinuar për bashkitë 12.8 miliard lekë. Nga buxheti i shtetit shkojnë për bashkitë rreth 51.9 miliard lekë. Nga 2.5 miliard lekë të ankoruara te Ministria e Mbrojtjes, rreth 600 milion lekë janë për emergjencat civile të bashkive, ndërsa fondi prej 200 milion lekë është fondi për investime për emergjencat për raste sezonale që u ndodhin bashkive. Rreth 1 miliard lekë janë në zërin e shpenzimeve kapitale në programin e emergjencave civile ku bashkitë mund të aplikojnë për projekte investimesh sipas kriterëve të përcaktuara në aneksin e këtij ligji. Ndërsa 500 milion lekë janë për rezervuarët e ujit dhe depozitimet e ujit për evitim të rrezikshmërisë së tyre, me aplikim nga bashkitë, sipas kriterëve të përcaktuara në aneksin e ligjit, ndërsa për mbetjet urbane janë dhënë 714 milion lekë. Nga Komisioni i Kuvendit janë dhënë 73 milion lekë për qarkun e Fierit për transportin e mbetjeve urbane. Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë dhënë 4.5 miliard lekë për investime në ujësjellës dhe kanalizime duke përshtatur me rregullat për konkurim në përfitimin e këtij fondi. Nga Ministria e Arsimit janë dhënë 2.2 miliard lekë për rikonstruksionin e shkollave në sitemin parauniversitar. Për shërbimin e ujitjes dhe kullimit janë 400 milion lekë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka akorduar 4 miliard lekë për infrastrukturën vendore. Fondi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 320 milion lekë, ndërsa për pastrimin e bregdetit janë 300 milion lekë. Rreth 17 miliard lekë janë si paketë e kushtëzuar për bashkitë. Nga muaji shtator stoku i borxhit të prapambetur nga 5.2 milion lekë është rritur në 7.8 milion lekë që tregon negativitet për shëndetin financiar të bashkive. Rreth 80 % e transfertës së pakushtëzuar shpërndahet sipas numrit të popullsisë i cili mbështetet te censusi i vitit 2011 dhe rakordohet me koeficientin e rritjes së popullsisë edhe nga INSTAT-i për një vit të caktuar si dhe nga gjendja civile, ku të dyja japin popullsinë prezente prej 3.335.940 qytetarë. Nëse një bashki ka sipas censusit 30 mijë banorë dhe gjendja civile 45 mijë banorë, sipas formulës llogariten 34.500 banorë, çdo njësi vendore merr 5.278 lekë për/banorë. Nga 34.500 banorë shumëzuar me 5.278 lekë për/banorë, del 132.91 mijë lekë. Kriter tjetër është dendësia e popullsisë për km², jo element bazik. Për të kompensuar koston shtesë nga faktorë të ndryshëm natyrorë në ofrimin e shërbimeve për bashkitë në limite në mbledhjen e taksave si dhe bashkitë me kushte klimaterike jo të favorshme që shtojnë koston e shërbimit, lidhur me këtë fakt, bashkia hipotetike me 34.500 mijë banorë shumëzuar me koeficientin e dendësisë së popullsisë për km², përfiton 83.772.900 lekë. Kriter tjetër është numri faktik i nxënësve për secilën njësi të vetëqerisjes vendore, që 5% e totalit të transferuar lidhet me këtë kriter, ku për një nxënës përfitojnë 3.120 lekë shumëzuar për numrin e nxënësve në shkollat e bashkisë. Skema e ekualizimit është që bashkitë

që kanë nivelin mbi mesatar të të ardhurave për frymë taton dhe u kalojnë bashkive me të ardhura për frymë nën nivelin mesatar. Gjithashtu, janë taksat e automjeteve, taksat personale, taksa e pasurisë që përbëjnë 1.040 lekë për frymë që u jepen bashkive. Bashkitë që kanë mbi 140% të këtyre të ardhurave duhet të kontribojnë. Bashkia hipotetike bazuar në ekualizim përfiton 304 milion lekë sipas formulës, një fond prej 113% më shumë se një vit më parë. Për qarqet zbatohet e njëjta formulë, por më e thjeshtë. Vijon puna për sistemin AMFIS për dixhitalizimin e operacioneve financiare në nivelin vendor si dhe ristrukturimi i informacionit të paketës fiskale për qeverisjen vendore duke ekspozuar të dhënat analitike dhe shpenzimet analitike. Problematikë është rishikimi i buxhetit për një skemë adekuate për vitin 2025 dhe censusi i vitit 2024 i cili me ndryshimin e popullsisë do ndryshojë dhe të ardhurat e bashkisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë po punon për të harmonizuar e kodifikuar procedurat e hartimit, përpunimit, raportimit të buxhetit sipas standarteve kombëtare e ndërkombëtare. Po riformohet skema e buxhetimit me bashkitë pilot në mënyrë që programet buxhetore të vlejnjë si instrument menaxhimi financiar me tregues konkret përformance.

Z. Arbjan Mazniku, Ministër Shteti për Pushtetin Vendor, njëkohësisht bashkëkryetar i Këshillit Konsultativ theksoi dy elemente të formulës;

- Mënyrën se si është aplikuar formula;
- Funkcionin dhe çfarë rezultatesh ka prodhuar zbatimi i saj.

Juliana Memaj, Kryetare, Bashkia Dimal vlerësoi transparencën për zbatimin e formulës dhe kërkoi që kur të dërgohet shuma përkatëse bashkive të shoqërohet me kalkulimet përkatëse. Bashkia Dimal është në pamjaftueshmëri të mbulimit të 47 kompetencave me këto të ardhura, ndaj duhet të kemi buxhetim nga qeveria jo vetëm për 6 kompetenca. 60 % e fondit shkon për rritjen e pagave të pushtetit vendor dhe për ofrimin e shërbimeve me standarde kombëtare dhe rritja e të ardhurave përbën vështirësi për shkak të largimit të popullsisë, por shërbimi duhet ofruar njësoj. Duhet me transparencë në pjesën e ekualizimit për taksat e ndara dhe të ardhurat për frymë, se kush bashki i jep tjetrit. Nuk u përmend taksa e kalimit të pronësisë dhe renta minerare si dhe nuk saktësohet sa e ardhur ka kaluar nga tatimi mbi të ardhurat. Të trajtohet më mirë bashkia Dimal duke qënë se 40% e fondit shkon për mirëmbajtjen e rrugëve.

Z. Gledjan Llatja, Kryetar, Bashkia Elbasan vlerësoi buxhetin me ndryshimet e tij dhe transparencën, por duhet të ketë një ndarje të drejtë sipas formulës duke përfshirë dhe performancën.

Në aneksin 2, të shtohet dhe përfshirja e pushtetit vendor ose e Shoqatës për Autonominë Vendore. Nuk kemi informacion për ndarjen e fondeve nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit edhe pse kemi dy përfaqësues.

Në tabelën 3, është e drejta jonë të kërkojmë buxhetin për funksionet e transferuara, si mbrojtja sociale nga 22 milion lekë duhet të bëhet 58 milion lekë, administrimi i pyjeve nga 14 milion lekë duhet të jetë 110 milion lekë, rrugët rurale nga 21 milion lekë duhet të jetë 65 milion lekë, ujitja dhe kullimi nga 16 milion lekë duhet të jetë 51 milion lekë. Në formulë duhet të futet dhe PBB.

Z. *Arbjan Mazniku* vlerësoi diskutimin e kryetarit të bashkisë Elbasan dhe kërkoi të dërgohen me shkrim/arsyetim bazik propozimet e dhëna. Jemi 10 vjet nga reforma që përbën kohë të arsyeshme për të riparë zbatimin e formulës që tashmë censusi do na japë një seri të dhënash të dobishme, përveç numrit të popullsisë dhe të situatës ekonomike/sociale të saj, në mënyrë që të diskutohet për elementet e formulës.

Ndërsa, buxheti për funksionet e deleguara duhet të kthehet në një diskutim praktik me një analizë thelbësore, por nuk do të thotë që do mbulohen plotësisht gjë që nuk ndodh as në vendet Evropiane. Diskutim tjetër duhet të jetë ushtrimi i kapaciteteve nga bashkitë për të mbledhur taksat dhe tarifat vendore ku mes bashkive ka boshllëk të gjërë.

Z. *Fran Brahimi* argumentoi se aneksi i ligjit ka shumë detaje dhe informacion nga sa u përmendën. 2% e të ardhurave ka 3 vite që u kalohet bashkive nga tatimi mbi të ardhurat si dhe dakordësoi shoqërimin e funksioneve me financat e duhura. Bashkitë duhet të kenë përfaqësues në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Në lidhje me elementët e formulës do diskutohen në vitin në vijim.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

2. Projektvendimi “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit”

Znj. Dardana Grabovaj, Specialist, Drejtorja e Strehimit, Minisria e Financave dhe Ekonomisë prezantoi projektvendimin “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit”, i cili ka për qëllim që programet e strehimit social të bëra nëpërmjet protokollit do pranohen vetëm në sistemin e-albania. 7 programet e strehimit social do bëhen domosdoshmërisht nëpërmjet sistemit. Bashkitë duhet të ngrënë struktura të posaçme për të ngritur këtë sistem. Procedurat dhe dokumentat janë të parashikuara në VKM nr. 384/2019 me të njëjtat programe por, legjitimon programet në sistemin online.

Znj. Adelina Farrici, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata për Autonominë Vendore vlerësoi pasjen e tryezave teknike nëpër bashki për konsultimin e projektakteve përpara se të konsultohen politikisht në Këshillin Konsultativ si dhe theksoi dakordësimin e aktit por, kërkoi rritje e kapaciteteve njerëzore në bashki për vlerësimin online.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004” Për sistemin e adresave” të ndryshuar

Z. Shpëtim Çokaj, Drejtor, Drejtorja e Administrimit të Regjistrave, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, prezantoi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004” Për sistemin e adresave” të ndryshuar. Projektligji ka për qëllim adresimin e çdo objekti, apartamenti, rruge, ndërtese në terrenin e bashkisë pavarësisht funksionit të cilat do të ruhen dhe mirëmbahen në regjistrin kombëtar të adresave. Ky

ligj parashikon të shtojë një element që është kodi unik i adresave, i cili përfshin të gjitha elementët e adresës. Iniciativa për këtë akt përmban zgjidhjen e problematikave në sistemin e adresave. Ligji parashikon sanksione për strukturat përgjegjëse që përditësojnë sistemin e adresave. Projektvendimi përcakton mënyrën e kodimit të kodit unik të adresës dhe algoritmin e tij. Kodi unik ka 8 elementë të adresës me 18 shifra për të identifikuar një apartament, dhe me 13 shifra për të identifikuar një ndërtesë. Roli i strukturave të bashkive është kryesor për krijimin e një sistemi adresash, nga ana tjetër mosadresimi i objekteve në terren shoqërohet me gjobë. Procesi udhëhiqet nga kryetari i bashkisë dhe raporton në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila monitoron dhe administron sistemin e adresave.

Znj. Juliana Memaj, Kryetare, Bashkia Dimal shtoi se nuk janë në relacion kostot financiare për implementimin e këtij ligji dhe përderisa nuk është shoqëruar me faturën financiare do mbetet i pazbatueshëm nga bashkia për mungesë fondesh.

Z. Shpëtim Çokaj argumentoi se do të kemi një buxhet për çdo bashki për emërtimin e adresave por deri tani nuk kemi ndonjë kërkesë nga bashkitë për fonde shtesë apo mungesë fondesh për implementimin e këtij procesi.

Znj. Juliana Memaj theksoi që kërkesa i është bërë publikisht ish-Ministrit Lleshaj.

Z. Aldrin Dalipi theksoi se shoqatat duhet të hartojnë kërkesën për fonde shtesë për procesin e adresarit dhe të kihet parasysh moszbatimi i penalteteve në rastin 90 ditor derisa të zgjidhet problemi i financimit për implementimin e sistemit të adresave.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

4. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

Znj. Kristina Puci, Specialist, Sektori i Drejtorisë Penale, Ministria e Drejtësisë prezatoi projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”, i cili rregullon programet për të miturit që kanë kryer vepra penale dhe në këto raste gjykata apo prokuria i cakton një shërbim të specializuar që ofrohet në nivel vendor, kjo bazuar në ligjin “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Bashkitë e ofrojnë këtë shërbim me anë të strukturave sociale, të cilat duhet të kenë dhe shërbimet përkatëse të specializuara. Në raste të mospasjes së këtyre strukturave mund të kontraktojnë shërbime të specializuara të licensuara në këtë fushë sipas ligjit “Për lejet dhe licensat”. Lidhur me programet që rrjedhin nga kodi i drejtësisë për të miturin duhet ti ofrojnë të miturit shërbime në fushën e psikologjisë, këshillimit arsimor, shëndetësor, për shmangien nga rruga e kriminalitetit. Këshillimi arsimor jepet për ndjekjen e një shkolle derisa gjykata të arrijë në vendimin përfundimtar të formës së prerë. Për rastet e masës së sigurimit është përcaktuar që i mituri duhet të ketë një menaxher rasti mbikëqyrës, përfshirë dhe persona të tjerë që asistojnë në drejtime si arsimit, aktivitet edukativ apo rekreativ. Shërbimet e specializuara duhet të bashkëpunojnë me strukturat e Policisë së

Shtetit dhe prokurinë. Financimi i këtij shërbimi duhet të jetë sipas ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Znj. Adelina Farrici argumentoi mbi fryrjen apo shtesën e stafit të bashkive për dhënien e shërbimeve që duhet të shoqërohen me financat përkatëse.

Znj. Kristina Puci argumentoi se shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin janë nëpër bashki dhe duhet të japin informacion në lidhje me mospasjen e kapaciteteve njerëzore apo mungesën e financave.

Z. Aldrin Dalipi theksoi se duhet të merren mendimet e agjencisë dhe të shoqatave për ndërmarrjen e procesit duke theksuar gjithashtu edhe mangësitat në zbatimin e këtyre shërbimeve për mungesë fondesh pa harruar që bashkitë ngarkohen me përgjegjësi në raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

5. Projektvendimi “Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale”

Znj. Denada Seferi, Zëvendësministër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, prezantoi projektvendimin “Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale”.

Draft-dokumenti i Politikave Sociale është hartuar nga qeveria shqiptare me qëllim krijimin e një kuadri të balancuar dhe të vazhdueshëm për të siguruar matjen, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes sociale në Shqipëri përmes një grupi treguesish të konsoliduar, duke përmirësuar kështu rrugët e lidhjes së përfshirjes sociale me përmirësimin e politikave të qeverisë dhe përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE. Ky dokument përmban objektiva dhe masa si lidhur me institucionet e qeverisjes qendrore, ashtu edhe për institucionet në nivel të qeverisjes vendore.

Dokumenti i Politikave Sociale parashikon detyrime dhe përgjegjësi në drejtim të NJVV lidhur me krijimin e strukturës burimore teknike e cila ka për qëllim përmirësimin e aftësive teknike dhe organizative për mbledhjen, monitorimin, analizimin dhe raportimin e përfshirjes sociale në strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe ndër aktorët e shoqërisë civile. Gjithashtu, bazuar në këtë dokument NJVV duhet të marrim masa për të përmirësuar sistemin e mbledhjes së të dhënave administrative në drejtimet që mbulon ky dokument politikash. Të dhënat administrative duhet të dokumentojnë statusin gjinor, të përkatësisë etnike dhe statusin e aftësisë së kufizuar të njerëzve që përdorin shërbimet publike.

Dokumenti koordinon, mat, monitoron çdo tregues që ka të bëjë me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale në 6 fusha varfërinë, mbrojtjen sociale, arsimin, strehimin, shëndetësinë, si detyrimin për t’u matur nga ministritë e linjës. Dokumenti krijon një sistem të qendrueshëm, të barabartë dhe gjithëpërfshirës. Në bashki nuk ka një dokument që tregon se sa është përfshirja sociale dhe aksesin e tyre në këto programe. Dokumenti nuk mbivendos statistikën edhe pse bashkitë raportojnë në INSTAT. Tre janë shtyllat kryesore të këtij dokumenti për përfshirjen sociale:

- Sisteme të qendrueshme për përfshirjen sociale për të drejtuar programet e saj dhe përmirësimin e dialogut politik;
- Mundësia për të vlerësuar apo raportuar përfshirjen sociale;
- Pasja e një ekipi burimor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vlerësuar ndërhyrjet në programet e përfshirjes sociale.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar

Znj. Herinda Duro, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve të Turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prezantoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

Zhvillimi i turizmit kërkon koherencë nëpërmjet akteve ligjore për aktorët që veprojnë në fushën e turizmit. Ndryshimet synojnë promovimin e Shqipërisë si destinacion autentik për vizitorët dhe karakterizohet nga përmbushja e kërkesave të turistëve dhe reduktim të informalitetit duke parashikuar rregulla për strukturat akomoduese të reja të përgjithshme dhe të pastandartizuara njësi, apartament etj, e cila do të sjellë të ardhura dhe për bashkitë, rritjen e shkallës së konsumatorëve dhe lehtësim të procedurave të ushtrimit të veprimtarive turistike dhe riorganizimin e strukturave përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në akt parashikohet hapja e një shtegu turistik për zonat rurale dhe mirëmbajtja e tij. Organizatat e menaxhimit të destinacionit vendor koordinojnë dhe monitorojnë, mbështesin ofruesit e shërbimeve për një qendrueshmëri në shërbime. Agjencia Kombëtare e Turizmit ka bërë një kalendar të eventeve turistike në të gjithë vendin. Janë rregulluar përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pastrimin e vijës bregdetare. Për statusin special për investitorët në njësitë akomoduese me 4 yje dhe 5 yje në fushën e agroturizmit janë parashikuar rregulla dhe masa në rastet e shkeljeve. Janë lehtësuar kërkesat për ushtrimin e aktiviteve turistike me fokus arsimin profesional. Për udhërrëfyesit turistik është hequr rinovimi i çertifikatës së tyre. Janë përcaktuar rregulla për stacionet e plazhit kur ka mospërputhje në hartëzimin e tyre.

Z. Rudin Beka, Nënkryetar, Bashkia Shkodër argumentoi mbi rregullat dhe zbatimin e tyre nga operatorët turistik, sigurinë në plazhe dhe rregullat mbi vrojtuesit në stacionet e plazhit.

Znj. Herinda Duro argumentoi se e njëjta praktikë do ndiqet dhe këtë vit, ku ofruesi i shërbimit duhet të ketë kontratën me vrojtuesin si dhe do forcohet kontrolli në terren nga Agjencia e Bregdetit me funksione të shtuara në organikë dhe grupe monitoruese, me masa shtrënguese administrative, ku bashkitë janë pjesë e grupit dhe janë inicuese në rastet e shkeljeve. Në sistemin e-albania do shihen aplikimet e ofruesve të shërbimeve në stacionet e plazheve, ku do të verifikohet dhe kontrata me vrojtuesit por, kjo mbetet punë dhe e kontrolleve në terren.

Z. Arjan Budo, Specialist, Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Rrugor, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shtroi pyetjen nëse ka risi në kontratën e transportuesit.

Znj. Herinda Duro argumentoi dhe në rastet e sigurimit të njësisve akomoduese dhe në raste të kontraktuesve të transportit turistik do ketë masa për moszbatim të rregullave nga kontrollet në terren.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

7. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimit dhe pagesat”

Z. Ylli Hoxha, Përgjegjës, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prezantoi projektvendimin “Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimit dhe pagesat”, i cili del në zbatim të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe është aset i bashkive për të rritur të ardhurat e tyre nga menaxhimi i qendrueshëm i fondit pyjor. Projektakti rregullon dhe orienton marrëdhënien e bashkive për të ruajtur gjendjen natyrale të fondit pyjor me entet e ndryshme të interesuar në shërbimet e ekosistemit.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

8. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për projektet që duhen t'i nënshtrohen oponencës teknike dhe procedurat që ndiqen”

Z. Ami Kozeli, Zëvendësministër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë prezantoi projektvendimin “Për miratimin e rregullave për projektet që duhen t'i nënshtrohen oponencës teknike dhe procedurat që ndiqen”, i cili synon rritjen e përgjegjësisë së inxhinierëve në realizimin e projekteve ndërtimore dhe rritjen e cilësisë së projektimit të objekteve ndërtimore në respektim të kushteve bazë si sigurinë nga zjarri, higjenë, kursimi i energjisë, efienca e objektit, mbrojtja nga zhurmat, siguri në përdorim. Akti nuk përafron me acqui-n e Bashkimit Evropian dhe është parashikuar në planin analitik të projektakteve 2023.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

9. Projektudhëzimi “Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”

Z. Ami Kozeli, Zëvendësministër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë prezantoi projektudhëzimin “Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”.

Projektudhëzimi ofron një rregullim pjesor me Rregulloren e Komisionit Evropian lidhur me shërbimin e transportit hekurudhor dhe rrugor. Udhëzimi përcakton kushtet e kontraktimit të shërbimeve publike me operatorët teknik. Akti është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 si dhe në Strategjinë e Sektorit të Transportit dhe planit të veprimit të saj. Akti vjen si nevojë sepse në Progres Raportin e vitit 2022 gjatë periudhës raportuese nuk ka patur progres në transportin rrugor që i përket kapitullit 14. Udhëzimi nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit në rastet e kontraktimit të shërbimeve publike me operatorët teknik.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t'i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

10. Projektudhëzimi “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumentave që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”

Z. Behar Selillari, Sekretar Teknik, Komisioni për Statusin “Dëshmor i Atdheut”, Ministria e Mbrojtjes prezantoi projektudhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumentave që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut” si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.

Nga pikëpamja ligjore, projektudhëzimi i propozuar është bazuar në nenin 9 pika 2 të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, i cili parashikon nxjerrjen e tij nga Kryetari i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Në zbatim të nenit 9 të ligjit të mësipërm, Ministri i Mbrojtjes ka ngritur grupin e punës, ku përcaktoi aktin për formatin e kërkesave për shpalljen “Dëshmor i Atdheut”. Objekti përcakton llojin e dokumentave dhe kërkesat për statusin “Dëshmor i Atdheut”. Akti ka për qëllim unifikimin e format kërkesës që shqyrtohen nga komisionet vendore të Këshillit të Qarkut/Këshillit Bashkiak/Prefektit dhe nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Dispozitat zbatohen për organet vendore dhe qendrore. Akti përcakton subjektet e këtij udhëzimi, objektet e kërkesës, organet ku paraqiten këto kërkesa sipas veçorive që kanë. Vendimet për refuzim të statusit “Dëshmor i Atdheut” mund të ankimohen pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Format kërkesa i bashkangjitet vendimit të komisionit. E rëndësishme është ndarja e dokumentave:

- a. në të përgjithshme që sillen në çdo rast;
- b. dokumenta provuese specifike të plotësuar nga personi, të cilat shqyrtohen nga komisioni.

Në udhëzim janë përcaktuar organet që propozojnë për status:

- a. Këshilli i Qarkut;
- b. Këshilli Bashkiak;
- c. Ministri për fushën e tij të përgjegjësisë.

Këto organe dërgojnë dokumentat në komisionin qendror për shqyrtim.

Pas diskutimeve u vendos që institucionit propozues t’i dërgohen komentet, mendimet, vërejtjet, propozimet e ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përmbledhjes së Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ.

11. Mbyllja e mbledhjes

Z. Dalipi mbylli mbledhjen duke falenderuar zëvendësministrat, kryetarët e bashkive si dhe pjesëmarrësit nga bashkitë dhe shprehu gatishmërinë për të mirëpritur komentet/sugjerimet për projektvendimet e konsultuara.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Arbjan Mazniku	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor	Kryeministria
2	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Shoqata e Këshillave të Qarqeve, Bashkëkryetar
3	Arjan Jaupllari	Zv/Ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
4	Denada Seferi	Zv/Ministër	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
5	Endrit Hoxha	Zv/Ministër	Ministria e Arsimit dhe Sportit
6	Gledjan Llatja	Kryetar	SHAV, Kryetar i Bashkisë Elbasan
7	Alma Hoxha	Kryetar	SHAV, Kryetar i Bashkisë Përmet
8	Ervis Moçka	Kryetar	Këshilli i Qarkut Vlorë

Shënim: Lutemi, materialet e diskutuara në mbledhjen e datë 4 Dhjetor 2023 mund ti gjeni në linkun e mëposhtëm.

<https://www.keshillikonsultativ.al/news/mbledhja-e-keshillit-konsultativ-4-dhjetor-2023/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ

E-mail: keshilli.konsultativ@mb.gov.al

Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.